



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.42

Prishtinë, më 24.2.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Bekim Haxhiu.

Pjesëmarrës të ftuar: Iber Alaj - MRKS, Besim Hasani - KOK dhe Astrit Haliti - FNK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.2.2016;
3. Diskutim në lidhje me gjendjen në sport;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.2.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim në lidhje me gjendjen në sport

Nait Hasani, tha se Komisioni është i hapur për bashkëpunim, me të gjitha institucionet, në kuadër të krijimit të infrastrukturës ligjore dhe krijimit të kushteve më të mira në fushën e sportit. Pjesëmarrja e sportistëve tanë në gara të ndryshme dhe sukseset e arritura në ato gara, janë një promovim i shtetit tonë.

Kryetari i njoftoi të pranishmit lidhur me një shkresë që i është adresuar Komisionit nga klubi i notit “STEP”, të cilët pretendojnë se ju është bërë e padrejtë në përzgjedhjen e sportistëve të këtij klubi për pjesëmarrje në gara të ndryshme. Më tej, fjala iu dha përfaqësuesve të ftuar.

Besim Hasani, kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), tha se rezultatet të cilat janë arritur në ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e sportit, janë rezultat i një bashkëpunimi të mirëfilltë të Komitetit Olimpik i Kosovës me MRKS-në, federatat dhe klubet sportive. Me pranimin e KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, janë hapur dyert për pranimin e të gjitha federatave ekzistuese, me përjashtim të Federatës së Futbollit, që pritet të pranohet nga UEFA dhe FIFA, gjatë këtij viti. Pasi jemi në vitin e olimpiadës, Kosova po bën përgatitjet për Lojërat Olimpike në Rio 2016. Pjesëmarrja e Kosovës në lojërat olimpike, është një e arritur e jashtëzakonshme. Përfaqësimi i shtetit do të bëhet nga tetë sportistë. KOK ka vështirësi në aspektin buxhetor. Këtu mund edhe të ketë ankesa, si nga klubet, ashtu edhe nga individë të ndryshëm. Me statut dhe rregullore është e përcaktuar mënyra e apelit, që mund të bëhet në kuadër të klubeve dhe federatave, mbase është e drejtë edhe të ankohen në Komision. Pas konsumimit të të gjitha mundësive të ankimit, ankesa mund të parashtrohet edhe në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv.

Iber Alaj - MRKS, tha se Ministria në vazhdimësi angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe se aktualisht është në fazën e licencimit të federatave. Në këtë rast, ka edhe ankesa sa i përket çështjeve të ndryshme. Me ndërkombëtarizimin e sportit ka përpjekje të individëve të ndryshëm që të jenë në krye të shumë institucioneve sportive, por me këtë rast, të gjitha licencimet do të bëhen në bazë të udhëzimeve administrative. Sa i përket shkresës, MRKS-ja e ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe është konstatuar se e njëjta nuk ka bazë ligjore. Ligji dhe Udhëzimi Administrativ parasheh kushtet dhe kriteret e themelimit të federatave.

Astrit Haliti, sekretar i Federatës së Notit të Kosovës(FNK), lidhur me këtë shkresë tha se e njëjta është parashtruar edhe në FNK, dhe si e tillë, nuk ka qenë e plotë dhe është refuzuar. Federata e Notit në Kosovë, ekziston që nga viti 1997 dhe janë mbajtur gara në kushte të jashtëzakonshme. Aktualisht, nuk kemi pishinë me dimensione olimpike dhe ballafaqohemi me probleme të shumta në organizimin e garave. Kosova ka 10 klube të notit dhe një klub të kërcimeve në ujë. Të gjithë personat që gjykojnë në gara të notit, janë persona të kualifikuar. Mirëpo, matjet bëhen në mënyrë mekanike(me kronometër), andaj edhe mund të ketë lëshime, por jo lëshime të qëllimshme, ku mund të dëmtohet ndonjë sportist. Rita Zeqiri, anëtare e këtij klubi është një prej sportisteve më të stimuluar në vend dhe shpreson që klubi në fjalë të kuptojë që Federata është e hapur për bashkëpunim. Kriteret për anëtarësimin e klubeve në FNK janë të përcaktuara me rregullore dhe këto kriteret duhet respektuar.

Salih Morina, tha se ka qenë vullnet i kryetarit të Komisionit të diskutohet për ankesën në fjalë. Kërkoj nga përfaqësuesi i MKRS-së, që çështjet e tilla të zgjidhen dhe të mos adresohen në Komision. Ndërsa, KOK-ut i sugjeroi, që në bashkëpunim me Komisionin, të adresohen kërkesa të ndryshme për mbështetje financiare, në mënyrë që Komisioni, në bashkëpunim me institucionet tjera përkatëse, të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë në sport.

4. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani